



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë

Qëllimi i revizionit:

Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- Të dhënat e paharmonizuara në evidencat për asetet fikse, stoqet, kompensim në para dhe masat aktive me evidencën e kontabilitetit;
- Detyrime të ndërmarra pa zbatuar PP mbi pragun e lejuar me LPP;
- marrëveshja kolektive jo e harmonizuar në nivel me rregullativën aktuale;
- mostërësi dhe saktësi në të ardhurat e realizuara.

Mendimi i dhënë/përfundim *:



Shprehëm mendim të pavolitshëm për të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosur.

Rekomandimet kyçe:

- harmonizimi i evidencës;
- zbatim i procedurave për PP në pajtim me LPP;
- harmonizimi i marrëveshjes kolektive me rregullativën ligjore gjatë llogaritjes së rrogave;
- Bashkëpunimi me institucionet tjera me qëllim realizimin e saktë dhe të plotë të të hyrave nga kontributet për punësime.

Dobësitë kyçe të sistemit:

- Ndryshimin e Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë për rregullimin e dispozitave për përgatitje, institucion kompetent dhe periudha e miratimit të planit operativ për masat dhe programet aktive për punësime.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Janë pranuar vërejtje prej të cilëve dy janë pranuar pjesërisht, dy janë pranuar me dëshmi plotësuese të dorëzuara dhe dy nuk janë pranuar për arsye se paraqesin informacione që i kishim parasysh gjatë kryerjes së revizionit.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Për vërejtjet e pranuar dhe pjesërisht të pranuar janë shpalosur përkatësisht në Raportin Përfundimtar të revizorit të autorizuar shtetëror.

* pozitive, me rezervë, të pavolitshëm, të përmbajtur